



Funded by  
the European Union



Advocacy Center  
for Democratic Culture

# Pozita e komunitetit LGBTQI+ në Kosovën Veriore



Center for  
Gender Studies  
and Research

ERA  
1681 Equal Rights Association  
for Women's Rights and Gender  
Equality

csgd  
Center for  
Gender Studies  
and Research

OMSA  
Organization  
for  
Montenegro  
Sexual  
Rights  
Advocacy



Queer  
Montenegro

QUE  
ERCE  
NTER

TUZLANSKI  
OTVORENI  
CENTAR

Botues: OJQ ACDC Qendra Avokuese  
për Kulturë Demokratike

Autore: Andrea Todić

Konsulentë: Ines Aljović, Stefan Kalaba

Dizajn dhe Shtypje: Night Design Studio

Ky botim u përgatit në kuadër të projektit të zbatuar nga OJQ ACDC, si pjesë e projektit më të gjerë "Së bashku për Barazinë LGBTQI+", i cili drejtohet nga Qendra për Edukim Qytetar (CGO), në partneritet me ERA - LGBTI Shoqata për të Drejtat e Barabarta për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, Queer Montenegro, Queer Center nga Shkupi, Tuzla Open Center, OJQ OMSA nga Shqipëria dhe Qendrën për Zhvillimin e Grupeve Sociale nga Kosova. Projekti financohet nga Bashkimi Evropian.

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e OJQ ACDC dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian, Qendrës për Edukim Qytetar ose partnerëve të projektit.

Tirazhi: 150 kopje



# PËRMBAJTJA

**07**

KORNIZA LIGJORE

---

**12**

HYRJE

---

**13**

TË GJETURAT NGA PYETËSORI

---

**34**

FOKUS GRUPET

---

**44**

INTERVISTAT

---

**48**

PROBLEMET KRYESORE.

---

**50**

PËRFUNDIM

---

# KORNIZA LIGJORE PËR MBROJTJEN E PERSONAVE LGBTQI+ NË KOSOVË

---

## 1. Garancitë kushtetuese dhe ligjore

Kosova është një nga vendet e pakta në rajon që ndalon shprehimisht diskriminimin bazuar në orientimin seksual në Kushtetutën e saj. Neni 24 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës garanton barazinë para ligjit dhe ndalon diskriminimin mbi çdo bazë, duke përfshirë orientimin seksual dhe identitetin gjinor.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi (Ligji Nr. 05/L-021), i miratuar në vitin 2015, specifikon më tej ndalimin e diskriminimit bazuar në orientimin seksual, identitetin gjinor dhe karakteristikat gjinore. Ky ligj është në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke përfshirë direktivat e Bashkimit Evropian, dhe i detyron institucionet publike të marrin masa proaktive për të parandaluar diskriminimin.

Ligji për Barazinë Gjinore (Ligji Nr. 05/L-020) përfshin dispozita që lidhen me personat LGBTQI+, veçanërisht në kontekstin e qasjes të barabartë në arsim, punësim, kujdes shëndetësor dhe pjesëmarrje politike. Ky ligj promovon blancin gjinor dhe i detyron institucionet të zhvillojnë politika që përfshijnë të gjitha identitetet gjinore.

Megjithatë, pavarësisht këtyre ligjeve, Kosova ende nuk ka miratuar një Kod të vetëm Civil që do të rregullonte bashkimet e personave të të njëjtës gjini. Projektkodi i'u nënshtrua disa herë diskutimit publik, por nuk u miratua për shkak të mosmarrëveshjeve politike dhe rezistencës ndaj dispozitave që do të mundësonin njohjen ligjore të bashkimeve të personave të të njëjtës gjini.

## 2. Mekanizmat institucional



Institucioni i Avokatit të Popullit luan një rol kyç në mbrojtjen e të drejtave të personave LGBTQI+. Avokati i Popullit ka mandatin për të hetuar rastet e diskriminimit, për të nxjerrë rekomandime dhe për të monitoruar zbatimin e ligjeve. Në disa raste, Avokati i Popullit veproi si "amicus curiae" para gjykatave, duke ofruar analiza ligjore dhe mbështetje për viktimat e diskriminimit.

Zyra e Qeverisjes së Mirë në Zyrën e Kryeministrit koordinon aktivitetet që lidhen me të drejtat e njeriut, duke përfshirë të drejtat e personave LGBTQI+. Kjo zyrë është përgjegjëse për hartimin e politikave, monitorimin e zbatimit të ligjeve dhe bashkëpunimin me shoqërinë civile.

Brenda kësaj zyre, u formua një grup ndërsektorial i punës për të drejtat e personave LGBTQI+, i cili bashkon përfaqësues të ministrive, shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare. Ky grup është përgjegjës për hartimin dhe

monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për të Drejtat e Njeriut.

### **3. Standardet ndërkombëtare dhe zbatimi i tyre**

Kosova është zotuar të respektojë standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, duke përfshirë:

Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (OKB, 1948),

Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike (OKB, 1966),

Konventën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut (Këshilli i Evropës, 1950).

Edhe pse Kosova nuk është anëtare e Këshillit të Evropës, shumë dokumente ndërkombëtare zbatohen përmes legjislacionit dhe angazhimeve politike. Organizatat ndërkombëtare si UNDP, EULEX, OSBE dhe delegacioni i Bashkimit Evropian në Kosovë ofrojnë mbështetje teknike dhe financiare për institucionet e Kosovës në përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave LGBTQI+.

### **4. Sfidat praktike dhe diskriminimi**



Pavarësisht përparimit në kornizën legjislative, personat LGBTQI+ në Kosovë ende përballen me sfida të shumta. Diskriminimi në arsim, punësim, qasje në shërbime shëndetësore dhe hapësira publike është i pranishëm, dhe gjuha e urrejtjes në media dhe në rrjetet sociale shpesh mbetet e pandëshkuar.

Shembuj nga praktika përfshijnë dëbimin e dhunshëm të një çifti gej nga një apartament me qira, sulmet fizike ndaj aktivistëve, si dhe refuzimin familjar të personave të rinj LGBTQI+ që rezultojnë në trauma psikologjike dhe nevojën për terapi. Gjatë debateve mbi Kodin Civil, deputetët përdorën gjuhë shumë diskriminuese, duke i quajtur personat LGBTQI+ "degjenerim" dhe "sëmundje".

## 5. Roli i shoqërisë civile

Organizatat joqeveritare si CEL Kosova (Qendra për Barazi dhe Liri) dhe CSGD (Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore) luajnë një rol kyç

në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave LGBTQI+. Ato ofrojnë ndihmë ligjore, mbështetje psikosociale, organizojnë fushata edukative, avokojnë për ndryshime në politika dhe bashkëpunojnë me institucionet në nivel lokal dhe kombëtar.

Këto organizata janë gjithashtu aktive në dokumentimin e rasteve të diskriminimit dhe dhunës, duke prodhuar raporte alternative për mekanizma ndërkombëtarë si OKB-ja dhe BE-ja, si dhe duke organizuar ngjarje publike që promovojnë përfshirjen dhe tolerancën.

## 6. Statistikat dhe opinioni publik

Sipas të dhënave nga organizata të tilla si Equaldex dhe ERA-LGBTI, Kosova ka një kuadër legjislativ relativisht progresiv, por një nivel të ulët të pranimi shoqëror të personave LGBTQI+. Hulumtimet tregojnë se një pjesë e madhe e popullsisë shpreh qëndrime negative ndaj komunitetit LGBTQI+, gjë që e bën të vështirë



integrimin dhe jetën e tyre të përditshme.

Pavarësisht kësaj, dukshmëria e komunitetit LGBTQI+ po rritet, veçanërisht përmes organizimit të Paradës së Krenarisë në Prishtinë, e cila mbahet që nga viti 2017 dhe mbledh një numër gjithnjë e në rritje pjesëmarrësish, përfshirë përfaqësues të institucioneve, organizatave ndërkombëtare dhe shoqërisë civile. Këto ngjarje kontribuojnë në normalizimin e pranisë së personave LGBTQI+ në hapësirën publike.

## 7. Rekomandime për përmirësim

Me qëllim përmirësimin e mbrojtjes së personave LGBTQI+ në Kosovë, rekomandohet:

- Miratimi i Kodit Civil që njeh bashkimet e personave të të njëjtit seks/gjini dhe rregullon të drejtat e tyre.
- Forcimi i kapacitetit të policisë, prokurorisë dhe gjykatave për t'u marrë me

rastet e diskriminimit dhe dhunës.

- Futja e edukimit rreth të drejtave të njeriut, orientimit seksual dhe identitetit gjinor në sistemin arsimor në të gjitha nivelet.
- Rritja e mbështetjes financiare dhe institucionale për organizatat e shoqërisë civile që punojnë me komunitetin LGBTQI+.
- Një fushatë më aktive kundër gjuhës së urrejtjes në media, duke përfshirë monitorimin dhe sanksionimin e shkeljeve.
- Zhvillimi i politikave lokale që promovojnë përfshirjen e personave LGBTQI+ në komunitete në të gjithë Kosovën.
- Përfshirja e çështjeve LGBTQI+ në të gjitha dokumentet strategjike përkatëse të Qeverisë së Kosovës, përfshirë Programin



për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut 2021-2025.

### **Përfundim**

Kosova ka bërë një hap të rëndësishëm në njohjen ligjore të të drejtave të personave LGBTIQ+, por zbatimi i ligjit, efektiviteti

institucional dhe pranimi shoqëror mbeten sfida. Nevojitet veprim i koordinuar nga institucionet, shoqëria civile, sistemi arsimor dhe partnerët ndërkombëtarë për të siguruar mbrojtje të plotë, përfshirje dhe dinjitet të personave LGBTIQ+ në shoqërinë e Kosovës.





# HYRJE

---

Organizata joqeveritare Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike (OJQ ACDC) zhvilloi një anketë gjithëpërfshirëse të opinionit publik kushtuar pranimi dhe cilësisë së jetës së komunitetit LGBTQI+ në veri të Kosovës. Hulumtimi u krye gjatë një periudhe prej tre muajsh dhe përfshinte tre qasje metodologjike plotësuese:

1. **Pyetësorë** — të kryer në internet dhe përmes versioneve të shtypura, me qëllim që të mundësohej një mbulim më i gjerë i pjesëmarrësve dhe qasje tek njerëzit që mund të mos jenë aktiv në internet.
2. **Fokus Grupe** — të mbajtura me përfaqësues të sektorëve dhe komuniteteve të ndryshme, në një atmosferë të kontrolluar dhe më konfidenciale, me qëllim thellimin e kuptimit të qëndrimeve, dilemave dhe kornizave të vlerave të pjesëmarrësve.
3. **Intervista** — biseda gjysmë të strukturuar që u lejonin anëtarëve të komunitetit LGBTQI+ të ndanin përvoja personale, sfida personale dhe perceptime të jetës në veri të Kosovës.

Qëllimi i pyetësorit ishte të mblidhte mendimet e publikut të gjerë në lidhje me komunitetin LGBTQI+ dhe të përcaktonte nivelin e informacionit, qëndrimet dhe shkallën e pranimi brenda popullatës lokale. Fokus grupet kishin për detyrë që, nëpërmjet dialogut të drejtpërdrejtë, të mundësonin një kuptim më të detajuar të perspektivave të akterëve të ndryshëm shoqërorë dhe të thellonin gjetjet e marra në fazën sasiore. Intervistat me vetë anëtarët e komunitetit LGBTQI+ ishin çelësi për mbledhjen e përvojave autentike, të cilat shpesh mbeten të padukshme në hapësirën publike.



Hulumtimi i paraqitur në këtë dokument është me rëndësi të veçantë sepse **është i pari i këtij lloji në veri të Kosovës**. Kjo analizë përfaqëson një hap fillestar, por të rëndësishëm drejt një kuptimi sistematik të pozicionit të personave LGBTQI+ në këtë pjesë të Kosovës dhe do të shërbejë si bazë për iniciativa, hulumtime dhe politika publike të ardhshme.

Rëndësia e gjetjeve reflektohet edhe në faktin se për herë të parë paraqiten të dhëna zyrtare mbi përvojat dhe sfidat e komunitetit LGBTQI+ në veri të Kosovës. Pyetësori është hartuar qëllimisht për të qenë i thjeshtë dhe i arritshëm, duke pasur parasysh se është hulumtimi i parë i këtij lloji, si dhe një temë e ndjeshme që kërkon një qasje të kujdesshme. Informacioni i mbledhur na lejon të shohim nivelin e njohurive të publikut të gjerë rreth temave LGBTQI+ dhe shkallën e pranimit shoqëror, si dhe përvojat personale të anëtarëve të komunitetit, gjë që jep një pasqyrë të plotë dhe të ekuilibruar të situatës aktuale në terren.

## TË GJETURAT NGA PYETËSORI

---

U mbledhën gjithsej 360 pyetësorë të plotësuar, nga të cilët 288 përgjigje u morën në internet, ndërsa 72 pjesëmarrës plotësuan versionin e shtypur të pyetësorit. Ky kombinim i metodave të mbledhjes së të dhënave bëri të mundur arritjen e një game të gjerë dhe të larmishme qytetarësh, përfshirë ata që kanë qasje të kufizuar në internet ose preferojnë një mënyrë më tradicionale të pjesëmarrjes.

Qëllimi kryesor i pyetësorit ishte të merrej një pamje e qartë e mendimit të publikut në veri të Kosovës në lidhje me komunitetin LGBTQI+. Disa aspekte kyçe u shqyrtuan përmes pyetjeve të përzgjedhura me kujdes: niveli i ndërgjegjësimit të qytetarëve për




terminologjinë LGBTQI+, kuptimi i koncepteve themelore që lidhen me orientimin seksual dhe identitetin gjinor, si dhe niveli i pranimet dhe hapjes ndaj anëtarëve të komunitetit LGBTQI+ në jetën e përditshme.

Përgjigjet e mbledhura përfaqësojnë një pikënisje të rëndësishme për analiza të mëtejshme, pasi ato ofrojnë një pasqyrë të qëndrimeve mbizotëruese, dyshimeve të mundshme, si dhe fushave në të cilat është e nevojshme punë shtesë për informimin dhe ndërgjegjësimin.

### Demografia

Nga një total prej 360 përgjigjesh, pak më shumë se gjysma (53%) ishin njerëz që identifikoheshin si femra, 44% ishin meshkuj, 1% ishin jo-binarë dhe 1% ishin të ndonjë identiteti tjetër gjinor, ndërsa asnjë person i vetëm nuk zgjodhi të mos i përgjigjej kësaj pyetjeje.



Shumica e pjesëmarrësve janë të moshës 26 deri në 35 vjeç, 47% e numrit të përgjithshëm, dhe më të paktit janë mbi 51 vjeç (1%) dhe nën 18 vjeç (3%).

Shumica dërmuese janë nga qyteti (82%), dhe vetëm 18% nga qytetet më të vogla.



Të anketuarit janë kryesisht me arsim të lartë, ku deri në 39% kanë përfunduar studimet master ose doktoraturë, ndërsa vetëm 6% e pjesëmarrësve kanë përfunduar shkollën fillore. Kjo na tregon se rezultatet e këtij pyetësi në fakt na japin mendimin e një shtrese të shoqërisë me arsim të lartë nga veriu i Kosovës, të moshës së mesme dhe nga qyteti.

Shumica e të anketuarëve janë të fesë ortodokse (57%), gjë që përkon me supozimet rreth strukturës së popullsisë në veri të Kosovës.




Plot 38% e të anketuarve u deklaruan si apolitikë, domethënë, si njerëz që deklarojnë se nuk janë fare të interesuar për politikën. Kjo përqindje është më e lartë se të gjitha opsionet e tjera të ofruara, gjë që e bënë atë shumë domethënëse për të kuptuar pamjen më të gjerë shoqërore.



Ky zbulim mund të shihet si një tregues i proceseve më të thella socio-politike në veri të Kosovës. Një nivel i lartë i mungesës së interesit të deklaruar në politikë mund të tregojë lodhjen e qytetarëve nga tensionet politike afatgjata, mungesën e besimit në institucione, ndjenjën se një zë individual nuk ka ndikim ose dominimin e temave që qytetarët i perceptojnë si të largëta nga nevojat e jetës së përditshme.

Në terma praktikë, këto të dhëna ndihmojnë gjithashtu për të kuptuar pse shpesh është e vështirë të motivohen qytetarët për t'u angazhuar në ndryshime shoqërore, iniciativa ose aktivizëm. Kur një pjesë e madhe e popullsisë vetëkategorizohet në grupin e atyre që nuk janë të interesuar, hapësira për angazhimin dhe mobilizimin e komunitetit bëhet më e ngushtë, gjë që ndikon drejtpërdrejt në efektivitetin e fushatave, projekteve ose përpjekjeve për reforma.

### **Pyetje rreth komunitetit**



Pyetja e parë, e cila është drejtpërdrejt e rëndësishme për këtë hulumtim dhe komunitetin, ishte rreth kuptimit të shkurtesës LGBTQI+, ku shumica dërrmuese thanë se e dinin - deri në 81% të përgjigjeve, afërsisht 14% e tyre e dinë se çfarë do të thotë, dhe


vetëm 6% e të anketuarve nuk e dinë kuptimin.

Përgjigje të tilla përfaqësojnë një tregues inkurajues për këtë, si dhe për hulumtime të ardhshme. Ato tregojnë se pothuajse i gjithë komuniteti lokal është tashmë në një farë mase i njohur me ekzistencën e komunitetit LGBTQI+, qoftë përmes mediave, rrjeteve sociale, njohjeve personale apo diskurseve publike. Fakti që tema nuk është plotësisht e panjohur për qytetarët krijon një pikënisje të rëndësishme për punë të mëtejshme,



veçanërisht kur bëhet fjalë për arsimin, rritjen e ndërgjegjësimit dhe përmirësimin e pranimi shoqëror.

Ky nivel informacioni bazë hap hapësirë për dialog më të mirë dhe mundëson që ndërhyrjet pasuese të drejtohen drejt thellimit të mirëkuptimit, thyerjes së stereotipeve dhe forcimit të tolerancës. Me fjalë të tjera, hulumtimi tregon se komuniteti nuk është në "pikën zero", gjë që krijon kushte më të favorshme për programet e ardhshme të mbështetjes dhe fushatat publike.



Një gjë tjetër pozitive është se deri në 78% e të anketuarve thonë se njohin personalisht më shumë se një anëtar të komunitetit LGBTQI+.

Nga numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve, vetëm 20 të anketuar deklaruan se nuk njihnin asnjë person që i përket komunitetit LGBTQI+, që është një përqindje dukshëm më e ulët se sa pritej. Këto të dhëna tregojnë se tema është shumë më e pranishme në jetën e përditshme sesa supozohet, qoftë përmes miqësive, njohjeve, marrëdhënieve të punës apo formave të tjera të ndërveprimeve shoqërore.

Ky rezultat hap gjithashtu hapësirë për një interpretim të rëndësishëm: nëse pothuajse 80% e qytetarëve kanë të paktën kontakt indirekt me anëtarët e komunitetit LGBTQI+, ekziston një probabilitet më i lartë që një sasi e caktuar mirëkuptimi, empatie dhe ndërgjegjësimi për realitetin e tyre është zhvilluar tashmë. Është konfirmuar tashmë në




kërkimet sociale se kontakti i drejtpërdrejtë me grupet e marginalizuara shpesh kontribuon në uljen e paragjykimeve dhe ndërtimin e qëndrimeve më pozitive.

Prandaj, ky rezultat mund të konsiderohet një pikënisje shumë e mirë për veprime të mëtejshme - si për fushatat që synojnë edukimin, ashtu edhe për iniciativat që synojnë përmirësimin e klimës shoqërore dhe inkurajimin e ndryshimeve pozitive. Ekzistenca e kontaktit të mëparshëm zvogëlon barrierat dhe e bënë shoqërinë më të hapur ndaj punës së mëtejshme mbi pranimin dhe përfshirjen.

Grupi tjetër i pyetjeve u konceptua në formën e një serie deklaratash, me detyrën që të anketuarit të vlerësonin shkallën e pajtueshmërisë ose mospajtimit të tyre me secilën prej tyre. U përdor një shkallë me pesë pikë, e cila mundëson një matje më të saktë të qëndrimeve dhe intensitetit të opinionit. Në këtë shkallë, një vlerë prej 5 do të thotë "pajtohem plotësisht", ndërsa vlera prej 1 do të thotë "nuk pajtohem aspak".

Kjo qasje ofron një pasqyrë më të detajuar të nuancave të qëndrimeve të qytetarëve, sepse nuk mat vetëm përgjigjet binare (po/jo), por edhe forcën e bindjeve që fshihen pas tyre. Kjo rezulton në një bazë të dhënash me cilësi më të lartë dhe më informuese për analiza të mëvonshme, veçanërisht mbi një temë që kërkon një kuptim të reagimeve komplekse sociale dhe emocionale.


#### Homoseksualiteti është një fenomen natyror dhe normal.



Përgjigjet e pyetjes së parë në këtë pjesë të pyetësorit tregojnë një ndarje të konsiderueshme në qëndrimet e të anketuarve, dhe një model i ngjashëm vërehet edhe në pohimet e tjera që përbëjnë këtë seksion. Megjithatë, pavarësisht këtij diversiteti, përqindja më e lartë e përgjigjeve gjendet në notat më të larta të shkallës, gjë që tregon se një pjesë e madhe e të anketuarve e pranojnë homoseksualitetin si një fenomen natyror.

Rezultati i dytë më i shpeshtë ishte 3, që tregon një qëndrim neutral ("as dakord, as jo"). Kjo përgjigje është një tregues interesant dhe i rëndësishëm: sugjeron që një numër i konsiderueshëm qytetarësh marrin një qëndrim të pavendosur, qoftë për shkak të mungesës së informacionit, dilemave personale, frikës nga dënimi shoqëror, ose thjesht ekspozimit të pamjaftueshëm ndaj temës. Kjo përgjigje "qendrore" përshkon një pjesë të madhe të këtij seksioni, gjë që konfirmon më tej ekzistencën e një game të gjerë qytetarësh që janë ende të pavendosur për çështjet LGBTQI+.

Në vijim, ne nxjerrim në pah të dhëna që në të njëjtën kohë mbartin një element inkurajimi, por edhe shqetësimi.




Nga njëra anë, deri në 63% e të anketuarve deklaruan se pajtohen plotësisht me pohimin se personat LGBTQI+ duhet të kenë të njëjtat të drejta si të gjithë qytetarët e



tjerë. Ky rezultat përfaqëson një sinjal të fortë se shumica e qytetarëve mbështesin parimin e barazisë dhe të drejtave themelore të njeriut, gjë që krijon një bazë të mirë për aktivitete të mëtejshme në fushën e përfshirjes dhe avokimit publik.

Nga ana tjetër, fakti që 14% e të anketuarve nuk pajtohen plotësisht me këtë pohim është shqetësues. Kjo do të thotë se 50 persona besojnë se komuniteti LGBTQI+ nuk meriton të njëjtat të drejta si anëtarët e tjerë të shoqërisë - që është një numër i konsiderueshëm, veçanërisht kur shihet në raport me totalin e 360 pjesëmarrësve. Ky rezultat tregon ekzistencën e qëndrimeve negative të rrënjosura thellë tek një pjesë e popullsisë, gjë që përfaqëson një sfidë serioze për të gjitha përpjekjet e ardhshme në drejtim të përmirësimit të të drejtave të njeriut dhe barazisë sociale.

Natyrisht, pyetja tjetër lidhet me promovimin e këtyre temave në publik. Shumica mendojnë se promovimi është në rregull, por ky numër nuk është i madh - vetëm 38% e të anketuarve mendojnë kështu.




Kjo pyetje është formuluar në formë negative, gjë që mund të jetë konfuze për disa të anketuar dhe e bënë të vështirë interpretimin e drejtpërdrejtë të përgjigjeve. Meqenëse deklarata sugjerojnë që temat LGBTQI+ "nuk duhet të promovohen" ose të diskutohen, konsiderohet pozitive për shkallën e pranimit që shumica e të anketuarve nuk pajtohen



me një pikëpamje të tillë. Me fjalë të tjera, shumica e qytetarëve mbështesin në mënyrë implicite hapjen e bisedës mbi këtë temë, e cila është një tregues i rëndësishëm i gatishmërisë së komunitetit për diskurse publike më gjithëpërfshirëse.

Megjithatë, pavarësisht mospajtimit të shumicës, fakti që 65 persona besojnë se temat LGBTQI+ nuk duhet të diskutohen në publik është shqetësues. Kjo përfaqëson një numër të konsiderueshëm individësh që ende preferojnë heshtjen, tabuizimin ose injorimin e kësaj teme. Një qëndrim i tillë tregon praninë e stigmës së rrënjësor thellë dhe barrierave sociale, të cilat mund të pengojnë përpjekjet që synojnë edukimin, dukshmërinë dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Deklarata tjetër në pyetësor sjell një rezultat veçanërisht interesant: numri i të anketuarve që pajtohen plotësisht është pothuajse identik me numrin e atyre që nuk pajtohen plotësisht. Kjo ndarje simetrike tregon një polarizim të fortë të qëndrimeve në komunitet, me të anketuarit të ndarë qartë në dy grupe pothuajse të barabarta - njëri që e mbështet fuqimisht deklaratën dhe tjetri që e kundërshton atë në mënyrë të barabartë fuqimisht. Ky lloj rezultati flet për ekzistencën e një teme të ndjeshme dhe konfliktuoze brenda shoqërisë, ku gjykimet e vlerave shprehen në polet ekstreme, dhe hapësira "e mesme" është dukshëm më e vogël se në pyetjet e mëparshme.



Të dhënat tregojnë një polarizim të fortë kur bëhet fjalë për përfshirjen e temave të diversitetit të identitetit në kurrikulat shkollore. Plotësisht 31% e të anketuarve e mbështesin plotësisht idenë që fëmijët duhet të mësojnë rreth llojeve të ndryshme të seksualitetit. Megjithatë, një qëndrim pothuajse po aq i fortë, por i kundërt, vjen nga 38% e të anketuarve të cilët besojnë se tema të tilla nuk i përkasin fare kurrikulës shkollore. Ky grup i percepton çështjet e identitetit si të ndjeshme, të papërshtatshme për fëmijët ose si përmbajtje që duhet të lihet jashtë arsimit formal, duke reflektuar ekzistencën e rezervave të thella shoqërore ndaj temave LGBTQI+.


Një pasqyrë më e detajuar e shpërndarjes së përgjigjeve është gjithashtu interesante. Kur tabela ndahet sipas shkallëve të pajtueshmërisë dhe mospajtimit, merret një rezultat pothuajse plotësisht simetrik:

- 43.1% e të anketuarve e mbështesin deri diku këtë pohim,
- 43.1% e të anketuarve nuk pajtohen deri diku,
- ndërsa 13.8% mbeten në kategorinë e të pavendosurve.

Kjo shpërndarje tregon një ndarje të dallueshme shoqërore dhe qëndrime të formuara qartë në të dy skajet e spektrit. Në të njëjtën kohë, një përqindje relativisht e vogël e atyre që janë të pavendosur tregon se tema është mjaftueshëm e pranishme dhe "e ngarkuar emocionalisht" sa që shumica e qytetarëve tashmë kanë një qëndrim të formuar - qoftë pozitiv ose negativ. Është informacion i rëndësishëm për krijimin e programeve, fushatave dhe politikave publike të ardhshme arsimore, sepse thotë se është një temë ku ndryshimet e vogla në komunikim mund të ndikojnë ndjeshëm në njërën nga dy palët po aq të forta.



Në këtë segment të rezultateve, mund të veçohet një vëzhgim pozitiv: një përqindje më e lartë e të anketuarve janë në shkallë më të ulëta pajtueshmërie me pohimin se orientimi seksual dhe identiteti gjinor janë rezultat i zgjedhjes së lirë. Kjo tregon se një pjesë e konsiderueshme e popullsisë njih që seksualiteti dhe identiteti gjinor janë dimensione komplekse të personalitetit, të cilat nuk janë çështje vendimi personal apo angazhimi të menjëhershëm.




Megjithatë, është shqetësuese që edhe 29% e qytetarëve ende besojnë se seksualiteti dhe identiteti gjinor mund të "zgjidhen". Kjo përqindje tregon praninë e keqkuptimeve të rrënjosura thellë dhe mungesën e informacionit rreth fakteve themelore që janë konfirmuar prej kohësh në psikologji, mjekësi dhe shkencat moderne shoqërore. Ky besim mund të kontribuojë në krijimin e stigmës, pritjeve të gabuara dhe qëndrimeve diskriminuese ndaj personave LGBTQI+.

Është gjithashtu e habitshme që 21% e të anketuarve mbajnë një qëndrim neutral ("as pajtohem, as nuk pajtohem"). Kjo përqindje tregon se një pjesë e konsiderueshme e qytetarëve nuk janë të informuar mjaftueshëm rreth koncepteve të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, ose thjesht nuk kanë formuar një mendim mbi këtë temë. Një rezultat i tillë nënkupton fuqimisht se në veri të Kosovës është e nevojshme të investohet në arsim dhe informacion publik, në mënyrë që t'u ofrohet qytetarëve



informacion bazë, i bazuar shkencërisht dhe të zvogëlohet hapësira për keqinterpretime.

Së bashku, këto të dhëna tregojnë një nevojë reale për punë të vazhdueshme në rritjen e ndërgjegjësimit, sepse as toleranca dhe as mbështetja sociale nuk mund të ndërtohen pa mirëkuptim të mjaftueshëm.




Kjo deklaratë rezultoi të ishte më polarizuesja në të gjithë pyetësin. Asnjë nga vlerësimet e ofruara nuk mori shumicë absolute, dhe përgjigjet u shpërndanë në të gjithë nivelet, gjë që tregon një ndarje të fortë të qëndrimeve ndërmjet të anketuarve. Numri më i madh i pjesëmarrësve zuri mesin e shkallës - ata që nuk janë të sigurt nëse pajtohen apo jo me deklaratën. Këto të dhëna sugjerojnë një shkallë të lartë të pavendosmërisë, por edhe një nivel të caktuar konfuzioni ose informacion të pamjaftueshëm rreth vetë temës.

Megjithatë, fakti që 26% e të anketuarve besojnë fuqimisht se komuniteti LGBTQI+ "flitet shumë" është veçanërisht shqetësues. Ky qëndrim është jashtëzakonisht domethënës, veçanërisht kur merret parasysh fakti objektiv se deri në qershor 2025, asnjë ngjarje, iniciativë, hulumtim apo projekt i dedikuar temave LGBTQI+ nuk ka ndodhur në veri të Kosovës. Ky kontrast zbulon perceptimin se çdo dukshmëri e



komunitetit - edhe minimale - mund të përjetohet si "shumë", gjë që tregon ekzistencën e ndjeshmërisë së shoqërisë mbi këtë temë, por edhe se vetë dukshmëria shpesh shihet si një presion i padëshiruar.


Nga ana tjetër, gjetja tjetër sjell një dozë optimizmi dhe hap hapësirë për një narrative më pozitive rreth pranimi. Plot 72% e të anketuarve deklarojnë se nuk do të kishin problem nëse një person i afërt do t'u thoshte se janë pjesë e komunitetit LGBTQI+. Këto të dhëna tregojnë qartë se, pavarësisht ndarjeve që rrethojnë dukshmërinë publike të temës, shumica e qytetarëve tregojnë një nivel të lartë tolerance personale në nivelin mikrosocial - brenda familjes, miqësisë dhe marrëdhënieve të ngushta. Është një burim jashtëzakonisht i rëndësishëm për iniciativat e ardhshme, sepse tregon se potenciali për ndryshim shoqëror ekziston pikërisht në hapësirën e ndërveprimeve personale dhe lidhjes ndërpersonale.



Empatia është qartësisht e pranishme tek banorët e veriut të Kosovës, gjë që përfaqëson një hap të parë të rëndësishëm drejt iniciativave të ardhshme të ndryshimeve pozitive.



Fatkeqësisht, përgjigjja e mëposhtme nuk na jep rezultate kaq pozitive.




Rezultatet tregojnë se shumica e të anketuarve bien në dy kategoritë ekstreme të përgjigjeve, gjë që tregon qëndrime të forta dhe të përcaktuara qartë për këtë çështje. Megjithatë, bie në sy fakti që 34.70% e të anketuarve besojnë se do të ishte e papranueshme që fëmija i tyre të ishte pjesë e komunitetit LGBTQI+. Kjo përqindje përfaqëson grupin më të madh brenda kësaj çështjeje dhe tregon qartë se çështja e pranimit prindëror është ende një fushë jashtëzakonisht e ndjeshme.

Ky rezultat sugjeron që, megjithëse në disa pyetje të mëparshme vërehet një nivel relativisht i lartë tolerance ndaj personave LGBTQI+ në kontekstin e miqësisë ose marrëdhënieve shoqërore, kur tema zhvendoset në fushën e intimitetit familjar - reagimet bëhen dukshëm më kufizuese. Ky është një model i zakonshëm në hulumtimet e kësaj natyre dhe tregon normat dhe frikërat shoqërore të rrënjosura thellë që lidhen me pritjet për rolin prindëror, presionet shoqërore dhe shqetësimin për sigurinë e fëmijës në një mjedis më konservator.



Ky rezultat është i rëndësishëm për planifikimin e mëtejshëm të ndërhyrjeve dhe fushatave, sepse tregon se është e nevojshme të punohet jo vetëm për tolerancën e përgjithshme, por edhe për forcimin e mirëkuptimit dhe mbështetjes brenda kornizave familjare — hapësira ku personat LGBTQI+ përjetojnë më shpesh si mbështetjen e parë ashtu edhe diskriminimin e parë..




Bazuar në përgjigjen e kësaj pyetjeje, mund të konkludohet se një pjesë e konsiderueshme e shoqërisë e njeh problemin e padukshmërisë së personave LGBTQI+, si dhe ekzistencën e formave të ndryshme të dhunës dhe diskriminimit ndaj të cilave ata janë të ekspozuar. Ky besim dëshmohet nga fakti se më shumë se 50% e të anketuarve e vendosën veten në pjesën e sipërme të shkallës së dakordësisë, duke shprehur kështu një vetëdije të qartë për sfidat me të cilat përballlet komuniteti.

Ky rezultat tregon se qytetarët e veriut të Kosovës, pavarësisht dukshmërisë së kufizuar publike dhe mungesës së iniciativave institucionale mbi këtë temë, ende e njohin ekzistencën e pengesave sistematike dhe sociale që ndikojnë në cilësinë e jetës së personave LGBTQI+. Kjo flet për një empati dhe kuptim të fshehtë të situatës, madje edhe ndërmjet atyre që mund të mos kenë kontakt të drejtpërdrejtë me anëtarët e komunitetit.



Kjo gjetje është një tregues i rëndësishëm se ekziston një gatishmëri e një pjese të popullsisë për të pranuar argumente dhe informacione në lidhje me nevojat, të drejtat dhe pozicionin e personave LGBTQI+, gjë që krijon një bazë të fortë për fushata, programe edukative dhe diskutime publike të ardhshme që synojnë uljen e diskriminimit dhe përmirësimin e sigurisë..

Megjithatë, pavarësisht një shkalle të caktuar ndërgjegjësimi për sfidat me të cilat përballen komuniteti LGBTQI+, një numër i konsiderueshëm i të anketuarve ende i konsiderojnë Paradat e Krenarisë si një provokim të panevojshëm. Ky qëndrim tregon se një pjesë e popullsisë nuk e njeh rëndësinë e vërtetë të ngjarjeve të tilla, as nuk e kupton rolin e tyre në luftën për barazi, dukshmëri dhe siguri të komunitetit.



Perceptimi i Paradës së Krenarisë si një ngjarje provokuese zakonisht buron nga mungesa e informacionit në lidhje me kontekstin historik dhe shoqëror - se këto ngjarje u ngritën si përgjigje ndaj dhunës sistematike, diskriminimit dhe trajtimit të pabarabartë të personave LGBTQI+. Prandaj, ky zbulim tregon se është e nevojshme të bëhet punë shtesë në edukim, në mënyrë që të shpjegohet më mirë se Parada e Krenarisë nuk është një akt provokimi, por një shprehje e luftës së përbashkët për të drejtat themelore të njeriut, lirinë e identitetit dhe dukshmërinë e barabartë në hapësirën publike.



Këto të dhëna sugjerojnë gjithashtu se ekziston një hendek i konsiderueshëm ndërmjet ndërgjegjësimit teorik për problemet e komunitetit dhe kuptimit të mekanizmave konkretë me të cilët adresohen këto probleme, gjë që është e rëndësishme për planifikimin e fushatave dhe aktiviteteve publike të ardhshme.

### **Ndikimi i arsimit në tolerancë dhe mirëkuptim**

Kur krahasojmë qëndrimet e të anketuarve me nivele të ndryshme arsimimi, vërehet se një nivel më i lartë arsimimi në përgjithësi shkon krah për krah me tolerancë dhe mirëkuptim më të madh ndaj personave LGBTQI+.

#### **1. Kuptimi i shkurtesës LGBTQI+ (A e dini se çfarë do të thotë?)**

Përfundim: Njohuritë për termin janë të lidhura me nivelin e arsimit. Gjysma e të anketuarve me arsim fillor nuk e dinë kuptimin.

| Niveli i edukimit          | Po   | Afërsisht | Jo   |
|----------------------------|------|-----------|------|
| I lartë (Fakultet, Master) | ~90% | ~8%       | ~2%  |
| I mesëm (shkolla e mesme)  | ~75% | ~15%      | ~10% |
| I ulët (shkolla fillore)   | ~50% | ~25%      | ~25% |

#### **2. Homoseksualiteti është një fenomen natyror dhe normal**

(Këtu shohim përqindjen e atyre që janë dakord - përgjigjet 4 dhe 5 në një shkallë nga 1 deri në 5)



| Niveli i edukimit          | Pajtueshmëria<br>(Vlerësimi 4 & 5) | Neutral<br>(Vlerësimi 3) | Mospajtueshmëri<br>(Vlerësim 1 & 2) |
|----------------------------|------------------------------------|--------------------------|-------------------------------------|
| I lartë (Fakultet, Master) | ~75%                               | ~15%                     | ~10%                                |
| I mesëm (Shkollim i mesëm) | ~55%                               | ~20%                     | ~25%                                |
| I ulët (Shkollim i ulët)   | ~25%                               | ~25%                     | ~50%                                |

Përfundim: Qëndrimi në lidhje me natyralitetin e homoseksualitetit është i lidhur drejtpërdrejt me arsimin. Ndërmjet atyre me arsim të lartë, 3 nga 4 persona pajtohen, ndërsa ndërmjet personave me arsim fillor vetëm 1 nga 4 persona pajtohet me këtë pohim.

### **3. Personat LGBTQI+ duhet të kenë të njëjtat të drejta**

(Këtu shohim përqindjen e atyre që janë dakord - përgjigjet 4 dhe 5 në një shkallë nga 1 deri në 5)

| Niveli i edukimit          | Pajtueshmëria<br>(Vlerësimi 4 & 5) | Neutral<br>(Vlerësimi 3) | Mospajtueshmëri<br>(Vlerësim 1 & 2) |
|----------------------------|------------------------------------|--------------------------|-------------------------------------|
| I lartë (Fakultet, Master) | ~85%                               | ~10%                     | ~5%                                 |
| I mesëm (Shkollim i mesëm) | ~70%                               | ~15%                     | ~15%                                |
| I ulët (Shkollim i ulët)   | ~50%                               | ~25%                     | ~28%                                |



**Përfundim:** Mbështetja për të drejtat e barabarta është jashtëzakonisht e fortë midis grupeve më të arsimuara. Deri në 85% e personave me arsim të lartë mbështesin të drejtat e barabarta, që është treguesi më i qartë i ndikimit të arsimit.

Të dhënat tregojnë pa mëdyshje se niveli i arsimit formal është një nga faktorët më të fuqishëm në formësimin e ndërgjegjësimit, pranimit dhe mbështetjes së komunitetit LGBTQI+. Dallimi në qëndrimet midis njerëzve me arsim të lartë dhe fillor është shumë i theksuar dhe i qëndrueshëm në të tre aspektet e shqyrtuara.

### **Përfundime**

Bazuar në rezultatet e pyetësorit, mund të nxirren disa gjetje kryesore që ofrojnë një pamje komplekse, por të qartë të qëndrimeve të qytetarëve të veriut të Kosovës ndaj komunitetit LGBTQI+:

- **Qytetarët e pranojnë se problemet ekzistojnë, por nuk kanë njohuri të mjaftueshme rreth kësaj teme.**

